

Ballina > Lajmet > Një person e plagos veten me armë në Podujevë

Një person e plagos veten me armë në Podujevë

06/05/2020

➦ Share

Facebook

Twitter

Google+

Email



Një person është vetë-plagosur në orët e vona të së hënës në fshatin Katunishtë të Podujevës, derisa tek sot Policia Kosovës e ka konfirmuar rastin, raporton Llapi.info.

Të dyshuarit, i kishte shkrepur arma dhe ishte plagosur në këmbë, me ç ’rast ka pranuar tretman mjekësor në QKMF-në e Podujevës dhe më pastaj edhe në QKUK.

Sipas raportit ditor të Policisë së Kosovës, në vendin e ngjarjes është gjetur dhe sekuestruar një gëzhjojë.

“Është raportuar se i dyshuari mashkull kosovar të cilit i kishte shkrepur arma e zjarrit dhe si pasojë ishte plagosur në këmbë. I dyshuari është dërguar në QKMF në Podujevë për tretman mjekësor, pastaj edhe në QKUK. Në vendin e ngjarjes është gjetur dhe sekuestruar një gëzhjojë, ndërsa në shtëpinë e të dyshuarit është sekuestruar një pistoletë me pesë fishekë e cila dyshohet se ishte përdor në rast. Në konsultim me prokurorin është iniciuar lënda e rastit dhe vazhdon të hetohet”, ka njoftuar PK.

Rastin e ka bërë të ditur tek sot Policia e Kosovës, përkundër përpjekjeve të portalit që të marrë detaje ditë më parë. I njëjti në PK është cilësuar si “armëmbajtje pa leje”./Llapi.info

➦ Share

Facebook

Twitter

Google+

Email

ARTIKUJ TË NGJASHËM MË SHUMË NGA AUTORI



PODUJEVË: SHËROHEN TË GJITHË PACIENTËT E PREKUR ME KORONAVIRUS, AKTUALISHT KJO KOMUNË S'KA ASNJË TË INFEKTUAR



PACOLLI: MILITANTËT E VV-SË MË KANË KËRCËNUAR FAMILJEN, DO DENONCOJ KURTIN DHE SFEÇLEN



AVDYLI (LDK): NDËRMARRJA E SHPEJTË E MASAVE KUNDËR COVID-19 E KA NDIHMUAR KOSOVËN

<

>